

URDHËR
Nr. 174, datë 15.4.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR VAKSINAT QË PËRDOREN KUNDËR
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT, NË PROGRAMET RUTINË TË VAKSINIMEVE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; pika 8, e nenit 102, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e kriterëve për përdorimin e vaksinave kundër sëmundjes së pseudopestit në programet e vaksinimit rutinë, sipas shtojcës I, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

SHTOJCA I

1 Në programet e vaksinimit rutinë, vaksinat që përdoren kundër sëmundjes së pseudopestit duhet të jenë të dobësuar dhe të përgatitura nga një shtam i virusit të sëmundjes së pseudopestit, ndaj të cilit është testuar dhe ka treguar se ka një indeks patogjeniteti intracerebral (ICPI):

a) më pak se 0.4, nëse administrohen jo më pak se 107 EID50 për secilin shpendë, në testin ICPI;
ose

b) më pak se 0.5, nëse administrohen jo më pak se 108 EID50 për secilin shpendë, në testin ICPI.